



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. *8673* Prot.

Tiranë, më *03.06*.2025

NJOFTIM
PËR VEND PUNE

SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.32, datë 18.02.2025, "Për miratimin e strukture dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore", i ndryshuar, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

1. Në pozicionin e specialistit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Ai/Ajo punon nën drejtimin e Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së. Është pjesë e ekipeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Përgjegjësitë e pozicionit përfshijnë menaxhimin e burimeve njerëzore si: procesin e rekrutimit, administrimit të dosjeve të personelit, menaxhimit të sistemit të regjistrimit të personelit HRMIS, procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve etj.

2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencia që kërkohet për këtë vend pune janë:

- Diplomë universitare në fushën e shkencave shoqërore. Diplomë Master dhe studimet pasuniversitare përbëjnë avantazh;
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune. Eksperiencia në institucione shtetërore përbën avantazh;
- Të ketë njohuri mbi legjislacionin për Kodin e Punës dhe organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërpersonale;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi në të shkruar dhe të folur në gjuhën shqipe dhe angleze;
- Të ketë aftësi në përdorimin e programeve bazë kompjuterike;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të punojë në ekip;
- Të ketë aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë;
- Të punojë vazhdimisht për zgjerimin e njohurive shkencore, profesionale dhe menaxheriale në mënyrë të dokumentuar;
- Të tregojë përkushtim ndaj misionit të institucionit.

Paga për pozicionin është në kategorinë IV-2.

Mundësi zhvillimi profesional i vijueshëm, trajnime profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 17.06.2025 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezes së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit si dëshmi të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida MYRTO

